

Perspektiva e Punësimit të Dilomuarve

Kërkesa e tregut të punës në Kosovë për profesionin e Inxhinierisë së Energjisë ka qenë veçanërisht e lartë në vitet e fundit. Në thelb, numri i vendeve të punës të krijuara në këtë grup është më i lartë se numri i studentëve të regjistruar në institucionet e arsimit të lartë.

Programi BSc Inxhinieria e Energjisë është krijuar në mënyrë strategjike për të përgatitur studentët me ekspertizën e nevojshme për të u ballafaquar në kompleksitetin e projektimit, promovimit dhe zbatimit të zgjidhjeve tradicionale dhe të rinovueshme të energjisë. Gjithashtu i përgatit ata të përshtaten me ndryshimet dinamike në industri, duke marrë parasysh faktorët specifik për Kosovën, rajonin dhe më gjerë. Si faktor specifik mund të përmendet edhe mosha mesatare rreth 60 vite ne Korporatën Energjetike të Kosovës – KEK.

UBT – Fakulteti Inxhinieria e Energjise ka Marveshje bashkëpunimi em Zyren e Rregullatorit të Energjisë – ZRRE, e cila ka miratuar Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031, e cila promovon potencialin për zhvillimin e energjisë së rinovueshme. Qëllimi i kësaj startegjie është krijimi i një mjedisi miqësor për investimet private në sektorin e energjisë, e cila fokusohet në energjinë solare, energjinë e erës, energjinë gjeotermale, biomasën dhe gazin si dhe bateritë për ruajtjen e energjisë, duke paraparë edhe rivitalizimin e Bllloqeve te Termocentraleve Kosova B. Qeveria e Kosovës synon arritjen e objektivave të përcaktuara nga direktivat e BE-së për përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, e cila edhe dëshmohet nga kjo Strategji e Energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031. <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/03/Strategjia-e-Energjise-e-Republikes-se-Kosoves-2022-2031.pdf>

Programi BSc Inxhinieria e Energjisë rrit komunitetin duke ofruar arsim dhe trajnim që fuqizon individët. Bashkëpunimi me sektorët e alumnit dhe industrisë na mundëson të adresojmë sfidat lokale, duke kontribuar kështu në mirëqenien dhe zhvillimin e gjithanshëm të komunitetit dhe rajonit tonë. Programi i studimit BSc Inxhinieria e Energjisë është i orientuar në mënyrë strategjike për të përmbushur objektivat kryesore të sektorit të energjisë. Ai përmban lëndë me përmbajtje bashkëkohore dhe të përditësuar, të karakterizuara nga fleksibiliteti dhe përshtatshmëria për të përmbushur kërkesat e tregjeve lokale, rajonale dhe globale.